Sh.Blacëri: Ne kemi 6 vjet që me ndihmën tuaj tashmë kemi krijuar një kooperativë që po punojmë me gratë ne nevojë. Unë si drejtuese jam shumë e kënaqur për idenë që hodhem në fillim. Ne duam të bëjmë hapa të tjera. Ju bëj vërejtje anëtarëve të Këshillit që janë pjesë e Këshillit të qarkut që të na ndihmojnë për aktivitetet që të zgjerojnë këtë kooperativë që kemi ne.

A.Prifti: Dua të falenderoj Shpresën për punën e palodhur dhe frymëzuese që bën.

A.Basho: Sa herë I kemi kërkuar Këshillit Bashkiak ndihma për viktimat e dhunës në familje. Dua të sygjeroj një fond për qëndrën e emergjencës për viktimat e dhunës në familje për të gjitha rastet që mund të kemi.

E.Gusho: Sot erdhi një email nga ministria që orientonte Bashkinë për të krijuar një fond social. Nuk është e thënë të jetë vetëm për gratë e dhunuara por për cdo ndihmë.

A.Basho: Unë fola sepse viktimat nuk I sjellim dot dhe po përcjell nevojat që kanë ato dhomat që I përdorin në rastet e emergjencave.

Esmeralda Doda: Jetoj në Pogradec, kam dy fëmijë dhe jam me ndihmë ekonomike, jetoj në shtëpinë e tezes. Dua një ndihmë nga Bashkia, ose një bonus qeraje.

I.Karapanca: Bonusi I qerasë është keqinterpretuar sepse I jepet atyre familjeve që për fatkeqësi natyrore të ndryshme ju prishet shtëpia dhe Bashkia I jep bonus qeraje perkohësisht derisa tju sistemohet shtëpia e tyre.

Esmeralda Doda: Ne të komunitetit Rom na penalizojnë.

Klea (Specialiste e drejtorisë së Shërbimit Social): Dua të flas pak për rastin në fjalë. Sa herë që kemi pasur mundësi I kemi cuar ndihmë të dy familjeve. Bashkia ju ka ofruar të gjitha mundësitë, dhe sa herë që kemi marrë telefonatë nga ju ne ju kemi ardhur në nevojë.

I. Karapanca: Nqs unë të jap 1 bonus qeraje për 6 muaj ti a ke mundësi të rregullosh shtëpinë dhe të kthehesh përsëri? Në momentin që ju jeni e aftë për punë ky bonusit hiqet si mundësi.

A. Basho: Ideja është që bonusi I qerasë është për faza tranzitore.

N. Kanina: Unë mendoj që fondi që kanë pasur për gratë dhe vajzat nga 500.000 lekë të bëhet 600.000 lekë.. Dhe së dyti në Pogradec ka shumë biznese që punojnë gratë dhe vajzat. A mund të futet Bashkia këtu për të diskutuar në lidhje me kushtet.

I. Karapanca: Për vitin 2026 Bashkia do të hapë cerdhen e re, pra do të bëhen 2 cerdhe në qytet.

-Mbajtësi I Procesverbalit , Sekretare e Këshillt

Jona Bojko





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Procesverbal

Konsultim publik : Diaspora dhe Emigrantët

Data : 21/11/20245

Ora : 12:00

Vendi: Salla e Këshillit

Bashkiak.

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 20 persona të pranishëm

Titulli : Mbledhja e rekomandimeve për PBA 2026-2028, Paketën Fiskale 2026 dhe Buxhetin 2026.

Pjesëmarrës :

Entela Gusho (Nënkryetare e Bashkisë)

Elda Pengu (Përgjegjëse tek Drejtoria e Shërbimit Social)

Vjollca Plaha (Këshilltare)

Ëngjëll Shyti (Këshilltar)

Suela Merikola (Punojse Sekretarjati)

E.Pengu: Përshëndetje! Ju falenderoj për pjesmarjen tuaj, jemi duke organizuar këtë takim për të diskutuar mbi buxhetin dhe paketën fiskale 2026. Bashkia Pogradec ka në Organikën e vet për herë të parë Diasporën dhe Emigrantët.Nuk

flasim vetëm për ata Emigrantë që ndodhen jashtë Shqipërisë por edhe për ata Emigrantë që janë kthyer.

Ne si Bashki kemi organizuar shumë aktivitete që të njihemi edhe ne me ju por edhe ju me ne. Është një risi e re edhe për ne, kemi nevojë akoma të përmirësohemi. Kemi disa Emigrantë të kthyer rishtrazi ku ne kemi patur kontakte të vazhdueshme me këta persona dhe ju kemi ardhur në ndihmë sa ne kemi patur mundësi.

Më shumë se sa flasim ne duhet tju dëgjojmë ju se ku mund tju ndihmojmë edhe kush janë problematikat tuaja. Ashtu siç e përmenda edhe më lart është një risi e re edhe për ne, prandaj na duhen sugjerimet tuaja se ku ne duhet të buxhetojmë.

Z.Gusho: Do mundohemi që kërkesat tuaja të meren parasysh për buxhetin e Vitit 2026.

Znj.Blerina: Përsëritet unë jam një emigrante e kthyer nga Bullgaria dhe për mua është një kënaqësi që u riktheva në Shqipëri. Unë momentalisht kam nevojë për një punë.

Z.Gusho: Institucioni I Bashkisë është një institucion orjentues, ne mund tju orjentojmë. Mund të bëni regjistrimin tek Zyra e punës ne lidhje me kërkesën tuaj. Ne jemi të gatshëm për tju udhëhequr se si mund ta kryeni këtë regjistrim.

Banorë e fshatit Leshnicë: Edhe unë dua të ngre problem pjesën e transportit, kemi problem me mos korektësinë e linjës.

Z.Gusho: Ju mund të shprehni edhe interesin për të hapur një aktivitet tuajin edhe Bashkia ju vjen në ndihmë, ne jemi këtu për tju ndihmuar që ju të hapni një aktivitet tuajin.

Ne duam mendime se si mund tju ndihmojmë konkretisht, Bashkia do diçka konkretë për tju ardhur në ndihmë.

Ne mund tju ofrojmë kurse pa pagesë për një zotë, është një mendim shumë i mirë.

Znj. Burbuqe Avokatja e Popullit: Synimi është që të futen në punë edhe Bashkia të bëhet urra lidhëse. Nuk e dimë dhe si është buxheti për emigrantët që kthehen sa mundësi kemi të ndihmojmë deri kur ata të sistemohen në një punë.



Znj.Blerina: Unë konkretisht diskutoj edhe për pjesën e transportit, jetoj në një fshat kemi pak problem transportin për të çuar fëmijën në shkollë.

Z.Gusho: Mund tju vemë një mjet për tju ardhur në ndihmë deri sat ë rregullohet. Do flasim specialistët që e mbulojnë këtë fushë, kërkesat e tua duhet të diskutohen edhe më ngushtë.

Banore: Babai im jeton shumë vjet në emigrim edhe nuk kthehet sepse ashtu si u përmënd më sipër është problemi I transportit. Ne nuk e përballojmë dot nuk kemi mjet transporti.

Znj.Ivana: Ne jemi këtu për të bërë të pamundurën, ne do e shpërndajmë informacionin për të gjithë ata që kanë nevojë, gradualisht edhe për ne është një informacin I ri por mundohemi të qartësohemi. Kërkesat tuaja do shqyrtohen pikë për pikë.

Znj.Elda: Po flas nga eksperiencia ime edhe unë fëmijën tim e kisha në një shkollë private, por e largova edhe e cova në Shtet, ne kemi shumë shkolla të mira, ju mund të thoni për kushtet por kushtet nuk I pengojnë për të marrë dijet e tyre. Nëse ju e keni të pamundur anën ekonomike.

Znj.Burbuqe Avokatja e Popullit: Janë kthyer shumë emigrant edhe në dijeninë time kanë hasur probleme me tokat. Duhet parë edhe pak kjo pjesë.

Znj.Elda: Kemi një zotëri midis nesh që është kthyer nga Kanadaja, Rigelsi. Ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me Z.Rigels për një problem për regjistrimin e fëmijëve.

Z.Rigels: Ashtu sic e shprehët edhe ju I vetmi problem I imi aktualisht është regjistrimi I fëmijëve. Mund tju them të gjitha punët janë bërë në kohën rekord , ju jam mirnjohës, ju falenderoj.

Z.Gusho: Bashkia I ka gjithmonë dyert e hapura ne jemi këtu për cdo problem që ju do hasni, Ne jemi pranë jush.

Ju falenderojmë për pjesmarjen tuaj.

-Mbajtësi I Procesverbanit, përcojësja e sekretariatit.

Suela Merdha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KËSHILLI

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 12/11/2024

Ora : 11:00

Vendi: Njësia Administrative Bucimas

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 26 persona të pranishëm

Titulli : Mbledhja e rekomandimeve për PBA 2026-2028, Paketën Fiskale 2026 dhe Buxhetin 2026.

Pjesëmarrës :

Manjoll Kamolli (Kryetare e Këshillit)

Anila Gjoshe (Këshilltare)

Klea Topa (Këshilltare)

Miranda Ollashi (Këshilltare)

Vjollca Pilaha (Këshilltare)

Alma Kanina (Drejtoreshë e Kabineti)

Enjela Karafili (Drejtoreshë, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore)

Jona Bojko (Sekretare e Këshillit)

Takimi drejtohet nga Kryetaria e Këshillit e cila bëri një prezantim të shkurtër :

M.Kamolli: Përshëndetje! Më lejoni tju përshëndes në emër të Këshillit Bashkiak, faleminderit që keni ardhur në takim në ditë të përvitshme për buxhetin dhe paketën Fiskale.

E. Karafili: Doja të thoja dy fjalë për paketën fiskale. Nuk do të ketë ndryshime as rritje të taksave. Po presim një VKM nga qeveria për taksën e pasurisë por qytetarët nuk preken nga kjo VKM. Lehtësimet për gratë dhe vajzat, pensionistët, vazhdojnë të jenë njësoj.

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Ëngjell Lickollari: Shpreh shqetësimin për problemin e rrugës nga varrezat e Starovës deri lart. Taksat I paguajmë të gjithë njësoj.

Astrit Hafesllari: Cfarë është parashikuar nga buxheti për Njësinë tonë?

A.Kanina: Në vitin 2026 do të mbyllen të gjitha rrugicat Brenda fshatrave.

Astrit Hafesllari: Bëhet fjalë vetëm për Starovën apo për të gjitha fshatrat?

A.Kanina: Për të gjitha fshatrat e kasha fjalën.

Kryeplaku Gurras: Gurrasi është fshati I vetëm që nuk e ka sistemin e kanalizimeve.

Përgjegjësi I Komunës Bucimas: Ne nuk kemi vegla pune për punonjësit, nuk ka veshje të posaçme, benzinë për makinën e kositjes. Ndricimi mungon në lagje.

Punëtor I komunës: Kam shumë kohë që punoj këtu dhe nuk kemi vegla pune.

Administratori I Nj. Adm. Bucimas: Keni menduar për zgjerimin e varrezave?

Merdan Latollari: Rruga Pogradec –Gështenjas është me ndricim, pjesa tjetër kur ikën për në Bahcallëk ka ngelur përgjysmë. Fshati Bahcallëk për tre shtylla ka ngelur pa ndricim.

Kryeplaku I fshatit Gështenjas: Pastrimi I trotareve , ujërat e zeza, ndricimi në lagje, kemi shumë llamba të djegura. Makina e mbeturinave nuk hyj në cdo lagje, vetëm në rrugët kryesore. Kazarë nuk kemi fare.

Bledi Hysa (Fshati Zërvaskë): Jam e interesuar për të marrë me qera kullotë për bagëtitë por dua garanci që të investoj.

K.Topa: Nqs ju I merri me qera normale që do I keni me garanci sepse do firmosni kontratë.

Kryetari I fshatit Rëmenj: Rrugicat e paasfaltuara, janë 4 lagje pa ujërat e zeza. Rruga kryesore që u asfaltua anash pa beton. Përsa I përket ndricimit janë 4 lagje pa ndricim.

Indrit Hafesllari (Fshati Rëmenj): Doja të pyësja në lidhje me faturimin e ujit. Kontratat e ujësjellësit janë bërë pas vitit 2014, ndërsa faturimi I ujit është bërë që në vitin 2009 dhe ne rezultojmë debitorë.

K.Topa: Ne si institucion nuk bëjmë dot veprim për të hequr atë debi sepse bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave . Ujësjetllësi nuk e mer dot përsipër ta bëjë vetë.

I.Hafesllari: Duhet të bëjmë një rezyme çfarë është bërë dhe çfarë do të bëhet. Hyrja në fillim të fshatit Rrëmenj është shumë e ngushtë. Rruga e pjesës së varrezave është jashtë funksionit. Pjesa e Rrugës Rrëmenj-Vërdovë duhet rehabilituar. Tokat e Rrëmenjit që janë pronësi shtet jemi të interesuar ti marrim me qera.

Kryetari I Fshatit Zagorcan: Kemi dy rrugë kryesore që lidhen me dy lagje dhe janë të paasfaltuara , duam të shtrohen me pllocka. Kërkojmë të investohet në fshatin Guras, Rruga nga varrezat deri në hyrje të fshatit.

K.Topa: Te fatura e ujit ju dalin të gjitha detyrimet . Në momentin që nuk ke shërbimin nuk paguhet taksa. E rëndësishmë është që këto ankesa që keni për ujësjetllësin ti drejtoheni personalisht.

Elektriciteti I Njësisë: Nuk është bërë asnjë investim. Rrjeti nuk është ndruar fare, është I vjetër muk ka asnjë mjet. Fshati Rrëmenj është pa drita. Me një siguresë janë 100 ndricues. Fshatrat Rrëmenj, Zdervaskë, Vërdovë duhet të ndrohen sepse ka ngarkesë në rrjet.

-Mbajtësi I Procesverbalit ,

Sekretare e Këshillit

Jona Bojko





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KËSHILLI

Procesverbal

Konsultim publik : Njësia Administrative Udënisht

Data : 12/11/2024

Ora : 13:00

Vendi: Njësia Administrative Udënisht

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 19 persona të pranishëm

Titulli : Mbledhja e rekomandimeve për PBA 2026-2028, Paketën Fiskale 2026 dhe Buxhetin 2026.

Pjesëmarrës :

Anila Gjoshe (Këshilltare)

Klea Topa (Këshilltare)

Vjollca Pllaha (Këshilltare)

Alma Kanina (Drejtoreshë Kabineti)

Enjela Karafili (Drejtoreshë, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore)

Jona Bojko (Sekretare e Këshillit)

Takimi drejtohet nga Kryetarja e Komisionit Juridik, K.Topa, e cila bëri një prezantim të shkurtër :

K.Topa: Përshëndetje! Ju falenderoj për pjesëmarrjen. Paketa Fiskale për vitin 2026 nuk ka ndryshime, përse I përket buxhetit deri në përfundimin e procesit të kanalizimeve ju jeni në dijeni që nuk vazhdojmë dot me investime.



I. Karapanca: Administratori ka sjellë gjithmonë shqetësimet dhe kërkesat që keni ju si komunë dhe ne jemi përpjekur tju vijmë në ndihmë.

Gafur Avdullari (Kryetar i Fshatit Lin): Unë kam vite që grindem por sot dua tju falenderoj. Jam grindur gjithë keto vite për kolektorin i cili tani po ndërtohet dhe firma që e ka marrë është shumë serioze. Në Mëmlisht për shembull po bëhet një punë shumë e mirë.

Sulltan Corbaxhi: Jam dakort me kolegun por tani është vetëm fillimi. Me ujësjellësin kemi problem akoma.

Daniel Dervishi: Kam një shqetësim. Në muajin më të thatë ne paguanim 1400-1500 lekë ndërsa tani paguajmë 4000 lekë.

K.Topa: Matësat nuk faturojnë më shumë se carxhohet. Nqs kemi rrjedhje është përgjegjësi e individit. Ka ndodhur që mund të caktohen matsat por në njësinë tuaj nuk duhet të ndodhë. Për pjesën e mbifaturimit, një përfaqësi e vogël të bëjë një ankesë te zyra te Rruga Rinia që të nisin inxhinierin që të verifikojnë.

Banor: Janë dy rrjete të ujit përkatësisht një që investoi Bashkia dhe rrjeti që u prish nga firma. Kur dëmtohet rrjeti duhet të vihet në dijeni.

Kryeplaku i fshatit Mëmlisht: Ne nuk kemi ujë 24 orë. Ka shkuar abonenti dhe e ka car me foto dhe video ankesën. Këtë problemin që kishtë zotëria parafolës ne e kishim gjithë vitin. Ne dhe sot e kemi me orar ujin, ndaj jam i mendimit që rrjeti i vjetër duhet të mbyllet dhe të bashkohet në një.

K.Topa: Ndërrhyrja në rrjet është vepër penale. Mungesa e ujit 24 orë vjen dhe nga mungesa e prurjes.

Kryeplaku i fshatit Mëmlisht: Prurje ka për të pasur, në varrezat e fshatit ka 6 muaj që nuk ka ujë. Tokë për varrezat nuk kemi, nuk kemi më hapësirë.

A ka ndnj projekt për të asfaltuar rrugët?

A.Kanina: Me të mbaruar kanalizimet do të fillojnë investimet.

Banor: Tek lagjia e Cervenakës duhet një kapazh.

Rezart Xhydollari: Bregu i liqenit është alarmant me rabeturina, na duhet një skllavator.

-Mbajtësi i Procesverbalit - Sekretare e Këshillit


Jona Bëllko
REPUBLICA E SHQIPËRISE
KOMUNA E KORÇES
KRYETAR I FSHATIT
CERVENAKËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 17/11/2025 **Ora :** 11 / :00 **Vendi:** Njësia Administrative Dardhas

Vendi: Shkolla Dardhas

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 22 persona të pranishëm (17 burra), (5 gra).

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

Mbledhja e rekomandimeve për PBA 2026-2028, Paketën Fiskale 2026 dhe Buxhetin 2026.

Pjesëmarrës :

Dritan Babasuli (Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë)

Miranda Olldashi (Nën Kryetare E Këshillit Bashkiak)

Vjollca Pllaha (Këshilltare)

Suela Merakola (Punonjse sekretariati)

Administratari: Përsëritet Mirë se erdhët, ky është një takim që ne e kemi bërë çdo vit është për projekt buxhetin e 2026. Kemi përfaqësues nga Bashkia Z. Dritan Babasuli dhe nga Këshilli Bashkiak

Të dëgjojmë Z.Babasuli.

Z. Babasuli: Si çdo vit ne bëjmë konsultimet për të dëgjuar edhe për të parë problematikat, normale buxhetet e kufizuara na detyrojnë të japim prioritet problematikave më serioze.

Banor i Fshatit Dardhas: Ne këtu kemi po të njëjtat problematika si vitin e kaluar.

Z.Babasuli: Pjesa e mirëmbajtjes?



Banori i Fshatit Dardhas: E njëjta situatë nuk ka ndryshime.

Administratori: Ne duhet ti themi edhe të shënohen.

Kryeplaku i Fshatit Stropckë: Parësore uji- del mbi asfalt, dherat nuk kemi ku ti cojme duhen hequr sepse po prishen asfaltet. Kemi vendosur shtyllat, elektrikisti nuk vjen fadromisti gjithashtu. Unë ato shtylla i vura vetë edhe sic i vura ashtu dhe do i shkul. I kerkuam të na dërgonin vincin as atë sna i dha, janë tuba hekuri sjanë tuba betoni se i kisha bërë edhe këto vetë. Edhe njëherë që e sollën fadromën na i morën unë nuk kam çfarë të shtoj më.

Administratori: Për 200 metra kabull presim 2 muaj.

Z.Babasuli: Ndoshta ska kabull.

Administratori: Kabull-ka por nuk vinë ta vendosin, po mundët të bëni dicka.

Banor i zonës: Një problem tjetër për sahatin, ti vendodet një celës se dritat ngelën hapur ditë e natë, e blejmë edhe vetë, por të vinë ta vendosin.

Elektriciteti s'vjen as njëherë janë disa gjëra që ne nuk mund ti bëjmë vetë.

Banori i zonës: Nuk e di si funksionon për pjesën e ngrohjes, sepse ne kemi sjell dru me qese për fëmijwt, dimri është i gjatë edhe i ftohtë nuk dalin.

Administratori: Kanë sjellë disa dru tani që janë shumë të thata ato digjen menjëherë të sjellin edhe disa të njoma edhe të kombinoen.

Po patët mundësi të ngrini zërin sepse janë fëmijë.

Banor i zonës: Këtu është zonë shumë e ftohtë si rrëgull është 15 Nëntor me 15 Mars të ulet pak të paktën të bëhet 1 Nëntor ose të shtohet 1 muaj edhe të zgjatet deri në 15 prill.

Z.Babasuli: Ajo që duhet të modifikojmë në këtë rast është sasia që të marim më shumë edhe të ngelen për vitin tjetër. Mënyra tjetër një muaj para me një muaj mbrapa, këtë problem nuk e ngrejmë dot ne sepse është e qëndrës.

Administratori: Ata nuk na sjellin sasinë që është përcaktuar se ne nuk e kontrollojmë dot.

Banor i Zonës: Si rregull kush e ka për ti futur drutë brënda? **Z.Babasuli:** Ata që i sjellin.

Banor i Zonës: Po edhe ata të çfarë mund të bëjnë dy janë, edhe ata na kanë ndihmuar.

Administratori: Janë disa gjëra që nuk i kemi në dorë ne, nuk kemi një elektrikist në zonë.

Z.Babasuli: Në dijeninë time, me sa unë jam i informuar këto kohët e fundit ka pasur probleme me tenderimet.

Administratori: Duhet të gjithë të kemi më shumë përgjegjësi, ne na duhet pak bazë materiale, psh për një karocë dore, pak përgjegjësi më shumë duhet të ketë që nga ne. Kuptohet edhe duhen shprehur.

Z.Babasuli: Normal problemet duhen shprehur, që të mundemi ti rregullojmë sa ne kemi në dorë.

Banor i Zonës: Për një makinë dhe të diskutohet.

Banori i Zonës: Rruga nga maja e Pilocës deri këtu duhet tw hapim me Xhisibi.

Administratori: Ne kemi disa pika, të paktën rrugën kryesore duhen hapur, kanalet gjithashtu. Në Mokrën e poshtëm i kanë lënë makinat në dispozicion.



Znj.Pilaha: Do mundohemi ti rregullojmë.

Z.Babasuli: Ne po diskutojmë me fondin e Zvillimit për të bërë rrugën e Shën Marenës edhe të Osnatit, shpresojmë që kjo të realizohet, ne jemi në kontakt të vazhdueshëm. Jemi në proces rristurimi. Vitin tjetër shpresoj që të kemi një shërbim më të plotë në këtë pjesë.

Administratori: Këto që po kërkojmë ne janë disa gjëra elementare. Këto janë humanizëm për punën që ne po bëjmë.

Z.Babasuli: Të jeni të sigurtë që çdo gjë po mbahet shënim edhe do shihen një për një.

Administratori: Ne kemi disa gjëra që nuk janë të vështira për tu realizuar por normal edhe të tjera që duhen kohë. Kemi kërkuar edhe asfaltin e rrugës të lagjes Hamolli.

Sistemimin e kanaleve, riparimin e catisë në njësinë Darrdhas na pikojnë qerramidhat, rrethimin e shkollës e heqim si pikë u bë aq sa u bë. Tek njëra pjesa e zjarrit.

Për festën në Gurin e Kamës bëhej më përpara tani nuk bëhet më, mirë ishte të bëheshe, të hidheshin pak lek, ta organizonim ne atë besoj se do bëhej shumë mirë atje në Gurin e Kamës. Nuk po themi për gjëra të mëdha por për disa gjëra të vogla që bihen në sy.

Banor i Zonës: Unë desha 6 metra tub edhe për dy vende që janë shumë keq, këto janë më të rëndësishmet, flasim për fshatin Lekas.

Banor i Zonës: Ne kemi parë që dru keni pse ato mos na jepen ne.

Z.Babasuli: Janë të sekuestruara dhe atje ne nuk mund të ndërhyjmë dot, momentalisht ato janë prova. Nuk janë vetëm në dorën tonë të gjitha janë edhe disa që ne nuk mund ti zgjidhim.

Jemi këtu për të përmirësuar punën tonë për tju dëgjuar.

Administratori: Jemi këtu për komunitetin, jo për gjërat personale që do ngrenë banorët e zonës.

Ju falemenderit! Nqs nuk keni dicka tjetër për të diskutuar e mbylлим këtu.

Mbajti Procesverbalin: Punonjëse Sekretariatit

Suela Mertani





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI**

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 17/11/2025 **Ora :** 12 / :30

Vendi: Njësia Administrative Cërravë

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 13 persona të pranishëm (11 burra), (3 gra).

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

Mbledhja e rekomandimeve për PBA 2026-2028, Paketen Fiskale 2026 dhe Buxhetin 2026.

Pjesëmarrës :

Dritan Babasuli (Sekretari I Përgjithshëm I Bashkisë)

Miranda Olldash (Nën Kryetare E Këshillit Bashkiak)

Vjollca Pllaha (Këshilltare)

Suela Mertkola (Punonjse sekretariati)

Administratiri Olger Ibi: Përshëndetje! Faleminderit për pjesmarjen, ky takim zhvillohet si cdo vit për buxhetin e vitit të ardhshëm. Ne duhet të shprehim problemet që zona jonë ka. Do zhvillohet një bashkëbisedim me përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak dhe me përfaqësuesit e Bashkisë jeni të lutur të shprehni kërkesat tuaja.

Z.Babasuli: Përshëndetje ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj! Ne jemi këtu për të dëgjuar ankesatat tuaja edhe nevojat që keni për zonën tuaj. Duhet ti shprehni që dhe ne të bëjmë planifikim e nevojshëm.

Z.Arbri Muca: Unë jam i interesuar të di diçka, pse na keni lënë kaq pas dore, ne si zonë kemi po të njëjtat kërkesa si vjet të kemi shpresën që do bëhen këtë vit. Fillojmë nga rrugët që janë ashtu sic ju i patë; magazinat e zonës janë si mos më keq duhet ndërhyrje do bien poshtë.

Banor i Fshatit Qershizë: Ne në fshatin tonë kemi shumë problem banesat e këtij fshati ju lutem mos na i lini pas dore.

Z.Agim: Përshëndetje po flas për fshatin Lumas. Ne kemi dy probleme që janë më urgjente. Te varezat duhet përcaktuar një vënd urgjent nuk ka më hapësirë dhe problemi tjetër është rruga.

Z.Lavdim: Unë përfaqësoj fshatin Leshnicë ne kemi një gjë i japim kërkesat por i bie si kot të paktën të japim pesë dhe të bëhen 2. Problemi jonë është ndricimi, kemi katër muaj që nuk shohim për këtë pjesë ne kemi folur edhe herë të tjera. Punimet kanë mbaruar mund të them që Kryetari është optimist, por ne problemin e kemi me punojësit. Problemi është tek kabulli. u hoq kabulli i vjetër edhe u bë investimi i ri dhe ne akoma presim ndricimin. Rrethimi i varreve të hyrja e varrezave dhe kërkojmë të kemi një strehë. Duam investim për një strehë edhe një tendë.

Rrugë në fshat ka akoma pa asfaltuar, kanalet e ujsjellsit duhen parë. Ka edhe shumë kërkesa të tjera që kanë banorët por të paktën këto.

Z.Babasuli: Keni të drejtë kërkesat janë dhe ne do bëjmë të pamundurën, ju faleminderit.

Z.Fatjon Bardhi-Grabovicë: Tek ne varrezat janë shumë keq duhet ndërhyrje urgjente, rrethimin e tyre duhet një tendë.

Pastaj kemi kanalet e rrugëve, beton dhe tubacionet, për momentin këto janë më urgjente, ju faleminderit!

Z.Dëfrim Hyka- Petrushë: Ne të gjithë po thuaj se kemi të njëjtat probleme.

Tek ne është problemi i varreve 12 vjet po e diskutojmë po bihen të gjitha bandjerrat.



Rruga po bije duam cakull flasim për 360 m rrugë është krim që akoma të diskutojmë këto gjëra, ne paguajmë taksa. Pastaj për ujësjellsin nuk mund të them u realizua.

Z.Dikellari-Nizhavec: Ne kemi një problem shumë të madh në fshatin tonë duhen urgjent zgjerimi i varreve,sheshi dhe rrugët e fshatit qarkullimi i brëndshëm ,ankohen cdo ditë banoret e fshatit dhe kanë të drejtë taksat paguhen.

Z.Klodian Oshafi-Blacë: Ne kemi problem në dy tre lagje kanalizimin e ujrave të bardha , problemi tjetër është rruga Lapidar-Alarup. Kërkojmë një fadromë për hapjen e rrugës. Ne si Kryepieq jemi cdo ditë atje edhe problemet më të mëdha janë për ne.

Problem kemi rrugën Alarup-Blacë-Alarup-Bletas. -

Agronomi: Kemi problem me vaditjen,janë dy rezervuar dhe vaditen 5 fshatra nuk mjafton. Duhet të bëhen kanalet e vaditjes edhe të cohen deri në vënd. Në Nizhavec duhen tre prita edhe edhe katër tuba.

Z.Babasuli: Ne po negociojmë për marjen e fondeve për këto rrugë të bardha,mos e merni si premtim por si angazhim, shumë shpejt fillon edhe shëtitorja.

Buxhetet Lokale janë shumë të limituar dhe ne do mundohemi të bëjmë të pamundurën.

Për pjesën e vaditjes do mundohemi të meremi këtë vit për ta realizuar.

Banor i Fshatit Cërravë: Kemi problem qentë, janë shtuar shumë.Kemi bërë dy herë kërkesë dhe jemi në pritje.

Kryepieq: Na vjen zor por deshim të diskutojmë edhe për pjesën e rrogave janë bërë shumë muaj.

Z.Ibi: Ju faleminderit për pjesmarjen tuaj.

Mbajtësi i Procesverbalit:

Punonjëse e Sekretariatit:

Suela Merikola





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Procesverbal

Konsultim publik : Njësia Administrative Proptisht

Data : 13/11/20245
Proptisht

Ora : 10:00

Vendi: Njësia Administrative

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 29 persona të pranishëm

Titulli : Mbledhja e rekomandimeve për PBA 2026-2028, Paketen Fiskale 2026 dhe Buxhetin 2026.

Pjesëmarrës :

Anila Gjoshe (Këshilltare)

Klea Topa (Këshilltare)

Vjollca Pllaha (Këshilltare)

Klajdi Bizgjoni (Përgjegjës, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore)

Besnik Xhyra (Këshilltar)

Jona Bojko (Sekretare e Këshillit)

Ramis Pura (Administrator i Njesisë Administrative Proptisht)

Takimi drejtohet nga Ramis Pura, administrator i Njesisë

R. Pura: Përshëndetje të gjithëve dhe faleminderit për pjesëmarrjen. Cdo vit Këshilli në bashkëpunim me administratën organizon një mbledhje për buxhetin dhe paketën fiskale, për të mbledhur shqetësimet dhe mendimet e banorëve.

Punë ka plot për tu bërë , ka dhe problematika, por në këto 6 vite është bërë goxha investim në Njësinë Proptisht.

Është realizuar uji në 8 fshatra, kemi dhe 4 fshatra që do fillojë së shpejti.

K.Topa: Sic ndodh cdo fundviti, Këshilli Bashkiak para miratimit të Buxhetit bën takime në cdo njësi administrative. Të gjitha ato që ju paraqisni do I delegohen kryetarit.

K.Bizgjoni: Paketa Fiskale për vitin 2026 nuk ka asnjë ndryshim, lehtësimet janë pot ë njëjtat.

R. Pura: Në lidhje me bizneset që operojnë nga ana jonë duhet të jenë më të kontrolluara, sepse vijnë e shfrytëzojnë resurset dhe nuk bëjnë asgjë që I kërkon fshati . E kam fjalën për bizneset e mëdha .

Bektash Alla(Fshati Vërri): Për ujin nuk kemi problem. Kemi problem rrugën nga ura deri në fshat. Brenda mundësive kemi dhe një rrugë në lagje , na duhet cakull për ta shtruar. Të na sjellin një mjet më të avancuar. Lagjia e Lekës- nuk ka kazane për mbeturinat.

Mislim Zydollari(Fshati Krickove): Për Krickovën ujësjellësi ka problem. Kemi problem me hyrje daljet në parcela. Na duhet një fadromë për rrugën e arrave.

Ndricimi Rrugor nuk ka rrjet fare , duhet investim fillestar. Kemi 40% të projektit që nuk është realizuar. Ka disa lagje që nuk preken nga projekti. Problem me kazanet e mbeturinave.

Suat Korca (Fshati Selishtë): Ne e kemi rrugën por një pjesë e kemi shumë malore. Një pjesë duhet të hapet me skllavator. Tek cezma kryesore e fshatit duhet një tub. Shkolla e Slatinës nqs mbyllet duhet të merren masa për transportin.

Xhevat Bego (Fshati Slabinjë): Pjesa më e madhe e gjërave janë realizuar. Tek pjesa e xhades nuk kanë përfunduar. Duhet një depo e re uji në Slabinjë.

Urim Leka(Fshati Proptisht) : Rruga nga asfalti deri në fshat duhet sistemuar. Materiali është por duhet të hapet dhe të ngjeshet. Kemi problem me kazanët e mbeturinave. Nuk vijnë dy herë në javë sic e kanë në kontratë. Lagjia e Celës do cakull, rreth 150m .



Besnik Kullolli(Fshati Golik): Rrugët janë por duhet pak riparim. Lagjet nuk janë pajisur të gjitha me ndricim. Lagjia Golik Lart dhe Lagjia e Krekës janë pa ndricim.

Një familje I kalon uji vadiës te shpia dhe është gati për tu shembur.

Kudret Mertkola(Rodokal Poshtë): Rruga e Letovës që lidhet me fshatin . Është një domosdoshmëri. Problem I varrezave duhet një vend I caktuar nga Bashkia sepse nuk ka më vend. Ka lisa të medhenj tek varrezat që duhet të priten.

Izja Leka (Slatinë): Rruga nga fshati Vëri në Slabinjë. Problemi I kazanëve, plehrat janë rrugëve.

Ilmi Torra (Fshati Zall Torre): Nuk kemi ujë të pijshëm fare. Jemi I vetmi fshat që skemi ujë fare.

K.Topa: Janë disa fshatra që nuk I kapi projekti.

Ilmi Torra(Fshati Zall Tore):Heqja e disa pemëve në varreza, sistemimi. Ndricimi Rrugor, lagjia lart në fshat.

Besnik Kullolli(Fshati Vëri): Rruga nga Goliku në Proptisht.

Ilmi Kamolli(Fshati Homean): Ujin e pijshëm e kemi si mos më keq. Rrjeti I brendshëm dhe I jashtëm është skandal dhe depoja është në gjendje shumë të keqe.. Rojen e ujit e bëj vetë që e hap dhe e mbyll , por nuk e përballoj dot më.

K.Topa: Kjo mungesa e punonjësve është pak problem sepse me urdhër na është cilësuar I punonjës për 1000 abonentë. Tani në muajin dhjetor jemi në një periudhë tranzicioni, do bëjmë një analizë dhe një riorganizim.Ne I kemi pasur jashtë strukturës me kohë të pjesshme por do marim masa patjetër.

Neim(Fshati Homezh): Unë kam problemin e rrugës por nuk e di nëse ka nisur projekti apo jo.

R. Pura: (Rodokal Siper) Këtë vit Kryetari e ka mbaruar projektin sepse ka mbaruar rruga e Katielit dhe po prisnim që të lidhej.

Njësia Proptisht ka marrë shumë investime. Tani kemi prioritet rrugën e Letovës. Na kanë thënë që në shtator do fillonte por akoma asgjë. Rrjetin Kryesor të ujit e

kemi me problem. Kazanët e mbeturinave nuk pastrohen shpesh dhe nuk janë mjaftueshëm. Rruga e varezave që nuk kalon xhenazja, duhet të ndërhyjë Dhimoja sepse është vërtet problem, duhet ndërtuar një mur.

Kazanët e mbeturinave nuk mjaftojnë, janë vetëm 5 copë, duhen më shumë. Uji i pijshëm është problem. Drejtori na tha që sa të hapet koha do fillojmë me tubin kryesor të ujit që ka difekt.

Fshati Somotinë: Rruga deri në Somotinë është shumë keq. Nuk futet makina e vogël fare. Kazanet e mbeturinave.

R.Pura: Rruga e Somotinës na është premtuar nga firma që bëri rrugën kryesore.

Besnik Xhyra(Këshilltar) : Fshati Selcë, ka problem rrugën kryesore e cila duhet zgjeruar. Rruga e vareve të Selcës duhet zgjeruar gjithsesi. Në fshat janë disa gardhe që duhen prishur. Mirëmbajtja dhe menaxhimi i varrezave të Selcës, nga viti 1978 nuk është investuar asgjë.

R.Pura: Në 8 fshatrat që është lidhur ujësjellësi të lidhet nga një degëzim. Para disa ditësh është bërë një analizë nga DSHP dhe uji i Slabinjës doli i papijshëm.

K.Topa: Ujësjellësi ka laboratorin e vet dhe duhet të vijmë vet që ta bëjmë analizën sepse shumë herë nuk na ka rezultuar njësoj.

B. Xhyra: Problematike ngelet asfalti rruga Rodokal Poshtë -Homezh; Ura e Golikut-Vëri-Proptisht-Slatinë. Ujësjellsat e fshatrave Rodokal i Sipërm, Rodokal Poshtë dhe Zall-Tore.

Mendoj që këto vijnë nga keqmenaxhimi i punës së drejtorëve dhe mungesa e organizimit.

-Mbajtësi i Procesverbalit, Sekretare e Këshillit

Jona Bojko



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KËSHILLI

Procesverbal

Konsultim publik : Njësia Administrative Velcan

Data : 13/11/2024
Velcan

Ora : 12:00

Vendi: Njësia Administrative

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 23 persona të pranishëm

Titulli : Mbledhja e rekomandimeve për PBA 2026-2028, Paketën Fiskale 2026 dhe Buxhetin 2026.

Pjesëmarrës :

Anila Gjoshe (Këshilltare)

Klea Topa (Këshilltare)

Vjollca Pllaha (Këshilltare)

Klajdi Bizgjoni (Përgjegjës, Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore)

Jona Bojko (Sekretare e Këshillit)

Ilia Mani (Administrator I Njesisë Administrative Velcan

Takimi drejtohet nga Ilia Mani administrator I Njesisë

K.Topa: Ju falenderojmë për pjesëmarrjen. Jemi mbledhur sic do vit para miratimit të Buxhetit dhe Paketës fiskale për të dëgjuar mendimet dhe sygjerimet tuaja për vitin 2026.

L.Mani: Unë kam bërë një përmbledhje se çfarë duhet në çdo fshat.



Fshati Velcan:

- Rikonstruktion I qendrës Administrative Velcan, kthimi I katit të parë në muze.
- Rkonstruktion I qendrës shëndetësore.
- Vazhdimi I asfaltit të segmentit nr 2 lokal(Noke) deri në fshatin Buzaishtë.
- Rrethimi I Varrezave.

-Sistemimi dhe shtrimi I rrugëve të lagjeve.

-Kanali vaditës –ujitës.

Fshati Buzaishtë:

- Rikontruksion I rrugës Brenda fshatit.
- Përfundimi I Ndricimit Brenda fshatit.
- Në proces. Ndërtim I tualeteve të shkollës.
- Rrethimi I varrezave.
- Sistemimi dhe shtrimi I rrugëve të lagjeve

Fshati Bishnicë:

- Përfundimi I ndricimit të Fshatit.
- Rrethimi I varrezave.
- Sistemim dhe shtrim I rrugëve të lagjeve.

Fshati Laktesh:

- Ndërtim I cesmave publike
- Përfundim I Ndricimit të fshatit



-Rikonstrukcion I rrugës Velcan-Laktesh-Somotinë.

-Rrethimi I varrezave.

-Sistemim dhe shtrim I rrugëve të lagjeve.

Fshati Senisht:

-Përfundimi I ndricimit të fshatit.

-Ndërtim I cezmës publike.

-Rrethimi I varrezave.

-Sistemimi dhe shtrimi I rrugëve të lagjeve

Fshati Losnik:

-Rrethimi I varrezave

Fshati Shpellë-Jollë:

-Rikonstrukcioni I urave të cilat shërbejnë për lidhjen e fshatrave.

-Rikonstrukcioni I ujit të pijshëm

-Rrethimi I varrezave

-Sistemim dhe shtrim I rrugëve të lagjeve.

-Pastrim dhe rikonstrukcionimi I kanalit të parë vaditës.

Rezervuari Frongovisht-Velcan.

Frongovisht-Buzaisht-Laktesh.

Mbajtësi I Procesverbalit , Sekretare e Këshillt

Jona Bojko





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 10/11/2025 Ora : 11:00 Vendi: Njësia Administrative Trebinjë

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 31 persona të pranishëm (25 burra), (6 gra).

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

Mbledhja e rekomandimeve për PBA 2026-2028, Paketën Fiskale 2026 dhe Buxhetin 2026.

Pjesëmarrës :

Fatmir Hamolli (Administratir I Njësive)

Klajdi Gjona (Këshilltar)

Celal Haxhillari (Këshilltar)

Vjollca Pilaha (Këshilltare)

Suela Mertkola (Punonjse sekretariati)

Administratiri: Përshëndetjet! Ky është një takim që ne e realizojmë çdo vit, është për projekt buxhetin e 2026. Duhet të shprehim shqetësimet dhe investimet që kërkon zona jonë në mënyrë që të paraqiten në buxhetin e vitit 2026.

Administratori: I japim fjalën Z. Hamolli edhe me radhë të diskutojmë problematikat, të dimë çfarë të kërkojmë dhe çfarë janë të mundshme të realizohen.

Z.Hamolli: Pak a shumë ju e thatë që këto mbledhje planifikohen në kuadrin e hartimit të Projekt Buxhetit për vitin e ardhshëm që do bëhet, prandaj edhe ne duam mendimet tuaja, për tu njohur me problematikat që janë aktualisht për tu rregulluar. Normalisht këtu ne do kuptojmë edhe vërtet se çfarë duhet bërë më mirë nga ne. Për ritjen e buxhetit edhe si ne kemi planifikuar si do hartohet buxheti ka ardhur përgjegjësi i Drejtorisë së Taksave edhe Tatimeve për tju dhënë një informacion më të detajuar.

Z.Bizgjoni: Paketa Fiskale për 2026 është e njëjtë.

Administratori: Ju japim fjalën Kryepleqve.

Z.Celnik: Para se ju të merni fjalën ju lutem më lini tju sqaroj diçka. Buxheti ka dy krahë, një krah është Paketa Fiskale dhe pjesa tjetër është pjesa e shpenzimeve kryesorja është investimi për të mirën e komunitetit. Për paketën fiskale u tha që ne nuk parashikojmë ndryshime vetëm se ne kërkojmë si Bashki dhe si Këshill sepse ju keni parë edhe ndodhitë që kanë ndodhur dhe duhet të sqarojmë diçka. Ju thonë që është toka ime, këtu në gjithë teritorin janë sistemuar sipas ligjit në një sipërfaqe të caktuar që quhet sipërfaqja e pronësisë. Ajo sipërfaqe që edhe kur u nda toka ju thanë edhe e lanë, ajo sipërfaqe është e gjyeshstërgjyshit ose e dikujt tjetër. Ka pas një ligj që ishte për kompesimin e tokave ose neto ose fizike, të gjitha ato toka që nuk u morën nga 7501 sipas ligjit duhet ti saktësoni të gjithë njerzit ose do kompesoheshin me tokë fizike ose me lek. Disa nuk shkuan ti kërkonin, ligji është izauruar ka mbaruar tani të gjitha këto toka ekzistojnë në shtet edhe si të tilla ne duhet të nxisim iniciativën, mund të kërkojmë të marim me qera për ta zhvilluar, nëse nuk ka iniciativa të tilla. Bashkia e ka pronën e vet edhe do ta japi me qera nëse nuk e mer ai që e ka pasur. Këto janë në kuadrin ku ne në të ardhmen mund të risim të ardhurat si për më shumë investime. Nga të ardhurat e investimeve për ato që ne kemi ngelen shumë pak të ardhura për të bërë investime të rëndësishme thjesht investime të mirmbajtjes të ndonjë ure. Këtu për investimin e rrugës së Shëmtërenës ju e keni marrë vesh që është hapur si procedurë ka shanse që të fillojë së shpejti. Dhe investimi i ujsjellësit që po bëhet vetëm këto dy janë në teritorin e Komunës Trebinjë aktualisht të tjera nuk ka. Tani çfarë ju të keni ne ju dëgjojmë.

Kryeplaku i fshatit Hondisht: Faleminderit që na mbledhët. Jam Ejton Braci sa për dëni kam prezent edhe Kryeplakun e fshatit Cezëm që vjen edhe jep mësim në Hondisht edhe problemi jonë i vetëm më madhor është rruga. Ka shkuar në ekstrem nuk mban më asgjë. Rrugët nuk po bëhen edhe kjo duket mbase mund të bëhet edhe nesër këtë nuk e di me siguri, unë di të them që Bashkia nuk ka mundësi të sjelli një skrap, një kamion e të vij të punojë një javë të vendosi 10 tuba në disa vende që është jashtë mase keq që nuk dalim dot hic. Ka njerëz të sëmurë ka moshë të thyer tani për 20 kamiona cakull që mund të duhen më 10 vende mund të shpëtojmë ne. Gjysma e të keqes do bëhet 1/10 jo 9/10 kaq dëshiroj unë nga Bashkia për momentin kjo është një punë emergjence nuk mban më. Na kanë ndodhur që kemi patur të sëmurë në mes të natës edhe na duhesh të lëviznim. Për 10 tuba edhe për 10 kamiona me cakull kjo nuk mund të bëhet.

Z.Hamolli: Tubat ku duhen?

Kryeplaku i fshatit Hondisht: Nëpër tubat që buron uji, ti vemë tubat që të kullojë uji, kaq dua unë prej bashkisë për momentin nuk po kërkoj as ta bëjë rrugën asfalt, të dalim si njerëz mos e tërheqim me traktor.



Z.Hamolli: Ajo do bëhet me cakull sic po bëhet kjo rruga, ke shumë të drejtë duhet bërë një ndërhyrje urgjente.

Kryeplaku i fshatit Hondisht: Kaq kisha ju faleminderit unë kaq kërkoj nga Bashkia.

Z.Hamolli: Që është lënë pas dore ke të drejtë sepse ndodhet firma këtu edhe është lënë nga firma të meret ndonjë fadrom të bëhet ndonjë punë e përkohëshme.

Arben Torollari (Cezma e madh): Edhe unë po të njëjtën problem kam, ngaqë jemi në atë sektor të njëjtën problem kemi. Erdhi traktori deri tek lumi, nuk mund ta ngjishte dot. Bashkia të pakten deri në breg ku ndahemi i ra deri te lumi sa e nivelei pak, atje ku ishte më keq atje e la. Rruga është mos më keq, dritat në fakt të jashtme për të lidhur një kontratë se e kemi diskutuar një mij herë, për pesë llamba. Që mos zgjatemi shumë për ato varrezat morëm herën e parë një konfirmim do pastrohen do bëhen absolutisht. Për ujin e fshatit prap ashtu jemi i cova deri tek vëndi ku është uji i burrim, prop su bë gjë.

Z.Kamolli: Kanë filluar këto për ujin do bëhet nuk i bie andej nga jemi ne, i bie të bëhet matanë lumit. I kemi disa gjëra dhe i kemi ekstrem, rrugët e lagjes nuk kalohet vetëm për dy makina cakkull me vjen turp që të diskutoj. Kemi edhe fshatarët që na thonë me të drejtë ju vini edhe shkoni dhe nuk po bëni asgjë.

Z.Baci Cezmë e Vogël: Pak a shumë të njëjtat problematika do ngremë ne jemi pak a shumë si grup andej dhe kemi të njëjtat problematika. Rruga është emergjente shumë edhe nga banorët kemi kërkesa shumë për kontratën e ujit nëqoftë se është e mundur ky investim që po bëhet këtej të arri edhe andej. Ka shumë por këto dy gjëra janë më emergjente.

Z.Kamolli: Po me dritat? E keni problem.

Z.Baci: Jo ne nuk kemi probleme ndricimin rrugor e kemi.

Z.Braci: Ne e kemi këtë problem mund të ndrisi një në 10 llamba.

Berti Haxhillari Kryeplaku i Fshat Gush Bardhë: Ne kemi ankesa në rradhë të parë për rrugët është e njëjta situatë për të gjithë. Erdhi Ujsjellësi bëri çfar u desh për vete, normal ata kanë punën e tyre por për 200 metro rrugë për tu lidhur një lagje është turp. Për të punuar një ditë punë është. Rruga tjetër që në Kalivac edhe deri poshtë është katastrofë nuk kalohet, nuk do vinë dot as arsimtarët për të sjellë nxënësit. Ujin na i morrën edhe e cuan nga atyre ju bëhej mirë. Dritat prap shënë kontratë asnjëhere.

Administratori: Janë 13 fshatra pa kontratë, kontratë ka vetëm Trebinja dhe Potgozhani.

Z. Berti: Ne jemi të rregull paguajmë çdo taksa.

Administratori: OSHB na ka thënë që duhet kontratë.

Znj Pillaha: Kur do i bëni?

Administratori: Kërkesat janë bërë këtu e me kohë janë cuar Z. Toni, ne jemi në pritje. Na është përgjigjur që po pret konfirmim nga Tirana. Ju lutem mund ta rikujtoni edhe njëherë z. Toni.

Z. Hamolli: Problemi kryesor janë rrugët e fshatrave.

Kryeplak i Sidomos me këtë Ujsjellësin ku do që kalojnë i kanë prishur edhe ashtu i lënë. Të njëjtën gjë edhe për cobenjtë ku do kalojnë, nuk pastrohen fare. Të hapen rrugët kush e ka në dorë ju lutem. Fshatin e bëmë me forcat tona e bëmë komplet beton edhe e prishën. Ti ndalojmë si ndalojmë dot nuk dimë nga tja mbajmë.

Z.Haxhillari: Kudo që ndërhyjnë ata edhe i prishin janë të detyruar ti rregullojnë.



Kryeplak 2: Rugën tonë duhet ta fillonin që në shtator, mbaruan punë edhe ikën ata. U hap kanali mes për mes, u prish rruga nuk u rregullua.

Kryeplak 1: Prandaj duhet të vijë Bashkia ta shtëngojë sepse një rast zjarri dicka ne marim fund. Këtu tek ne vetëm shkatërrohet asgjë nuk rregullohet.

Z. Haxhillari: Urgjentisht kryetari i Bashkisë me përgjegjësit e rrugës.

Administratori: Meqë jemi tek uji kemi marrë vesh për kontratat që lidhja e kontratave do jetë 100 mik lekë, ndërkohë që fshatrat që kanë bërë kontrata më përpara ka qënë 40 mije lekë, nuk kemi informacion mos ndoshta ka ndryshuar ligji. Ju lutem pyesni nqs mundeni.

Z. Haxhillari: Unë e kam të freskët edhe është 100 milek nqs ndryshon dicka për fshatin nuk mund të them.

Administratori: Kjo tek ne është për herën e parë, ndërkohë që në të gjithë fshatrat e mokrës ka kushtuar 40 milek. Kjo është një problematikë që më mirë ta themi që sot sepse do ngrihet prap

Kryeplaku 2: Një problem që ka dalë sot në Kalivac, kanë shkuar ata të rrugës edhe kanë bllokuar rrugën, fshatarrët i hoqën sepse nuk kishin nga të kalonin.

Z. Hamolli: Më falni se po ju ndëroj temë, po ju them për kontratat që do dalin se tani sa bisedova dhe më thanë shumë shpejt.

Administratori: Rikthehem prap tek rruga e Kalivacit ne atje të bëjmë një kërkëse të paktën të zhblokohet rruga poshtë.

Z. Haxhillari: Në Kalivac janë dy rrugë është një rrugë e shukrtër që e kanë zhblokuar ata edhe një rrugë e gjatë. Skanë pse e bllokojnë ata.

Banorët: Të dyja janë keq si rrugë ato.

Kryeplaku i Fshatit Potgozhan: Rruga në Potgozhan është shumë keq drejtimi që shkon poshtë për tek infermeria është një pjerësi e keqe shumë keq edhe cakulli që vihet apo zhavorri njëherë të bie shiu e gërren. Na vjen turp sepse thonë pse nuk i pastrojnë, pastrohen por me rreshjet e shiut ndoth prap e njëjta gjë. Ajo duhet të shtrohet me cakull edhe të ngjishet me rrul, kanalizime ska. Këtë kam unë.

Administratori me pak fjalë fshatrat e Mokrës së sipërme janë cop cop janë të vdekura.

Banorët: Hyjet në mokrën e poshtme kënaqesh, vjen këtej nga ne. Vënd më të varfër se nga ne nuk gjen

Z. Haxhillari: Këtu ka një problem që bazën materiale për rrugët me shkëmbin e shkrin por nuk mban. Do bëhet rruga e Shën Mërenës të bëhet një impiant në Shën Mërenë që të meret edhe të shtrohet që andej rruga kur bëhet fjalë për të marrë materia.

Banorët: Materialin e keni ja ku e keni në Kalivac ne kemi filts cakullin ashtu sic e shtroi firma e vjetër. Vetëm mer e ngarko, nuk po e duam që nga Pogradeci edhe këtu.

Kryeplaku i Fshatit Pleshisht: Kam 20 vjet Kryeplak kam luftuar edhe luftoj me fshatin dhëmb për dhëmbë tani ato rrugët që u premtuan. Për ato rrugë kemi 20 vjet që spo i heqim nga goja. Ujë, rrugë këto edhe që kanë ikur njerëzit vetëm për këto kushte kanë ikur edhe ikin akoma. Në Pleshisht kanë qënë 210 familje dhe tani jemi 30 familje. Ilin nga kushtet kjo rruga që na u bë edhe hallall i qoftë ai që na vuri dorë kjo të ishte bërë më parë. Na i shtruan atë rrugë me asfalt po pse nuk e cuan edhe 100 metro në një lagje ne kaq kërkojmë ne duam këto kushte. Ne kemi disa probleme sot për sot, ne kemi

problemën e autokombanjës na ka zënë kjo firma rrugën dhe nuk ka ku të hyj autokombanja. Nuk kemi një kalim për bagëtitë, thuhet do shtrohen do vijnë të rinjtë nga do vijnë këta të rrinj si mund të shtojnë blëgtorinë kur nuk kemi një kalim të kalojmë. Vetëm për ujë që erdhi po vijnë njerzit nga ana e anës. Në rrugë në Plëshisht kemi patur që në kohën e Zogut mos kemi tani. Tani na erdhi kjo firma edhe i ra mes për mes. **Z. Hamolli** : Ata detyrohen ta bëjnë ashtu sic ishte rrugën. E ka me kontratë është paguar për atë punë rrugën duhet ta bëjë më të mirë. Në kërkojmë nga Këshilli të vijnë 2-3 veta edhe ti takojmë të zgjidhen problemet e fshatit. Për autokombanjën unë dua një përgjigje nga Këshilli.

Banori: Ju ja kanë lënë vendin hyn autokombanja.

Z. Petrit Zeqollari: Kam sjellë disa dokumenta, i kam evar edhe në Bashki por nuk kam marrë një përgjigje, janë nga firma që na kanë bllokuar rrugën na kanë bllokuar bagëtitë nuk kemi ku të kalojmë, hajdeni tju cojmë që ta shikoni me sytë tuaj.

Z. Hamolli: Sikur kanë bërë një rrugë.

Z. Petrit Zeqollari: I kanë bllokuar tani, në skemë ku të pijmë ujë. Tani e kanë bllokuar merjetë. E keni me skicë çdo gjë. Rruga është 25 ha dhe nuk punohet një dylm.

Z. Kamolli: Problemi në zonë është rruga është katastrofike.

Banori: Mokra e Poshtme nuk ka paguar as njëherë taksë drush.

Z. Kamolli: Janë paguar.

Banori: I paguajmë taksat është shumë gjynah.

Banorët bëjnë thirrje të sillen mjetet për rrugën.

Z. Kamolli: Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj çdo kërkesë e juaja nuk do rrijë pa u diskutuar dhe do bëjmë të pamundurën ti zgjidhim.

Mbajtësi i Procesverbalit : Punonjëse e Sekretariatit

Suela Mertkola